RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Blerina Huruglica Eksperte Shqyrtuese	11.05.2022	20.05.2022	*123/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.05.2022 **GOE"Samire Osmani"B.I&"Besim A.Zejnullahu"B.I,** kanë parashtruar ankesë me nr. **123/22** kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë G**OE "Mburova" SHPK "Zona Park"N.SH.H,** lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull: **"SPËRKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE"**, me nr. të prokurimit: **62500-22-2616-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE .**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 60 000,00 €

Data e njoftimit për kontratë.....31.03.2022.
Hapja e ofertave.....12.04.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....14.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....18.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....26.04.2022.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE

Dispozitat e shkelura sipas OE ankuesit:

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:

- **Neni 1**
- **Neni 6**
- **Neni 7**
- **Neni 51**
- **Neni 56**
- **Neni 59**
- **Neni 60**
- **Neni 72**
- **Neni 108/A**
- **Njoftimi mbi Vendimin e AK – Letra standarde per tenderuesin e pasuksesshem**

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet të OE ankuesit:

Konform nenit 108\A dhe brenda afatit ligjore te parapare ne nenin e permendur parashtrojm kerkese per rishqyrtim, me pretendimin se nuk jane respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, sepse ju keni rekomanduar per kontrate nje operator ekonomik te papergjegjshem.

Gjate qasjes ne dokumete zyrtare ku ishin te pranishem edhe zyrtari i prokurimit, kemi verejtur nje ser shkeljesh dhe kerkesa te FDT-se te cilat operatori ekoonomik i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotesuar:

1. Ne FDT, keni kerkuar pajisje, mjete dhe stabilimente dhe nder te tjera keni kerkuar tre (3) fumigator dhe DY DEPOZITA UJI ME NGA 2000 LITRA. Gjate qasjes bashke me zyrtarin te prokurimit konstatuam se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar as minimumin e kerkeses per faktin se ne ofert ka ofruar depozita te cilat nuk e arrijn as 1000 LITRA. Sa i perket 2 depozitave te kerkuara, se pari nuk pranohet qe te ofrohen disa depozita sepse AK-ja ka kerkuar vetem 2 depozita me nga 2000 litra. I rekomanduari per kontrate ne listen

e pajisjve e ka dhene vetem nje depozit dhe per te njejten nuk ka ofruar asnje deshmi sic eshte kerkuar fatura, Dud ose Kontrate te shfrytezimit me qera.

Fakti qe OE i rekomanduar per kontrate ne listen e pajisjeve ka ofruar vetem nje depozit, AK-ja ka mundur te kerkoje informata shtese, mirepo fakti qe i njejti nuk i ka prezantuar ne listen e pajisjeve minimumin e kerkeses ateher autoriteti kontraktues duhet ta shpall te papergjegjshem, sepse nuk ka ofruar asnje deshmi dhe nuk e ka ofruar kapacitetin as per se afermi.Andaj Grupi I Operatoreve Ekonomike me vetem kete pretendim ankimor duhet te shpallet I papergjegjshem.

2. Ne FDT, keni kerkura epidemiolog ose biolog te diplomuar. I rekomandauri per kontrate ka ofruar diplomen e epidemiologes Lebibe Hashanit, e cila eshte punetore e Institutit Komebtare te Shendetit Publik ne Prizren, e cila perben konflkt te hapur interesi per faktin se implementimi i projektit ne fjale menaxhohet me IKSHP dhe komunen e Malisheves dhe per kete do ti drejtohemi organeve kompetente dhe IKSHP-se. Lidhur me kete fakt kerkojm nga ju qe ta verifikoni me shkrim nga epidemiologja faktin se e njejta a eshte e angazhuar ne kete kompani sepse sipas informacioneve tona kjo epidemiologe nuk punon tek kjo kompani dhe per kete edhe ne do ti drejtohemi edhe IKSHP-se lidhur me kete ceshtje sepse nje person nuk mund te jete i angazhuar ne te njejten kohe ne dy vende te punes dhe mbi te gjitha perben konfilkt te pasur interesi pasi qe IKSHP me ligjet ne fuqi eshte edhe mbikqyrese e procesit te sperkatjes se etheve hemoregjike Krime-Kongo ne tere Kosoven dhe poashtu duke perfshire edhe komunen e Malisheves .

3. Ju keni kerkuar sigurim te ofertes dhe gjate qasjes kemi verejtur se sigurimi i ofertes eshte ne emer te anetarit te konzorciumit e cila bie ne kundershtim me vet marreveshjen e themeimit te konzorciumit sepse lider ne kete aktivitet te prokurimit eshte Mburoya Shpk, dhe ne kete rast grupi i operatoreve ekonomik ne marrveshjen e themelimit te konzorciumit jane deklaruar se Mburoya do ti perfundoje 60% te puneve e cila ne ofert ka dorezuar vetme certifikaten e biznesit, TVSH-se dhe deklaraten nen betim dhe ne kete rast as sigurim te ofertes nuk ka ne emer te liderit e cila eshte ne kundershtim me dispozitat e ligjit per prokurim publik.

4. Ne FDT, te pajisjet keni kerkuar 2 automizer elektrostatik multifunksional per dezinfektim hapesinore. OE i reomanduar per kontrate ne deshmit e ofruar per kete pajisje ka ofruar pajisje te cilat nuk jane ELEKTROSTATIKE sic jane kerkuar, por jane elektrike dhe per pajisjen ne fjal kerkojme qe te verifikohen permes web faqes ose edhe tek prodhuesi i paisjes. AK – Komuna e Malisheves dhe komisioni vleresuar nuk ka kryer vleresim dhe krahasim te ofertave ne perputhje me LPP Neni 59.

Grupi i Operatorëve Ekonomik i shpallur fitues nuk i ploteson shume kritere te njoftimit per Kontrate andaj AK ka vepruar ne kundershtim me Nenin 59 te LPP-se.

- NE KËRKOJM NGA AK-KOMUNA E MALISHEVËS QË TA APROVOJ SI TË BAZUAR KËRKESËN PËR RISHQYRTIM DHE PROCESIN TA KTHEJ NE RIVLERESIM . NE DO TË PROCEDOJMË EDHE NË INSTITUCIONE TJERA TË CILAT JANË TË SPECIFIKUARA ME LIGJE PASI QE KONSIDEROJME ME PLOTE BINDJE SE KOMISONI I VLERESIMIT DHE AK JO VETEM NE KETE AKTIVITETET TE PROKURIMIT POR NA KA TRAJTUAR EDHE NE AKTIVITETE TJERA NE MENYRE DISKRIMINUESE .

Te nderuar pasi pranuam vendimin e kerkeses per rishqyrtim, konstatojm se AK-ja, ne kundershtim me nenin 108/A nuk eshte pergjigjur ne pretendimet tona ankimore te parashtruara ne kerkesen per rishqyrtim. Pasi ka pranuar kerkesen per rishqyrtim,AK-ja, ne kundershtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 ka kerkuar inofrmata shtese lidhur me disa deshmi ekzistenca e te cilave nuk ke qene e fiksuar para hapjes se oferteave sepse OE I rekomanduar per kontrate nuk ka dorezuar fare deshmi lidhur me 2 depozitat e kerkuara ne FDT, por vetem per nje ka ofruar deshmi dhe fakti qe AK-ja kerkon deshmi shtese per nje deposit tjeter perben ndryshim material te ofertes dhe kete e verteton fakti se ne kerkesen e AK-se drejtuar OE te rekomanduar per kontrate, nuk kerkon deshmi shtese, POR E PYET SE A E PLOTESON KERKESEN, kjo tregon se AK-ja nuk ka bere vleresim fare sepse ofertat jane dorezuar 12-04-2022 ne ora 14 e 30, ndersa vendimin e ka publikuar me date 14.04.2022 per nje kohe relativisht te shkurter kohore kur dihen fare mire qe dosja e tenderit e dy OE ofertues ka qene voluminoze dhe AK konkretisht Komisoni I vleresimit me nguti apo fare ska bere vleresim te duhur dhe professional te ofertave .

Autoriteti kontraktues, ka vepruar ne kundershtim me dispozitat e nenit 10 sepse kemi bere kerkese per qasje dhe te njejttit nuk na kan ofruar dhe jane deklaruar se ka kerkese per sekret afarist.Edhe perkunder qe AK I kemi kerkuar qasje ne vleresimin e tenderit AK deri ne momentin e ankeses dhe sipas ligjit nuk na ka ofruar qasje ne vleresimin e dyte(heren e pare na eshte lejuar qasja mirpo e kufizuar).Shifet shume qarte se AK eshte shume favorizues ndaj Grupit te OE fitues pasi ne qdo menyre na eshte kufizuar qasja dhe poashtu eshte favorizuar grupi I OE fitues (per kete edhe kam dorzuar Ankese me date 26.04.2022 ne Agjensionin per Informim dhe Privatesi kund AK) .Kjo vertetohet edhe me faktin se me te njetin procedure per sperkatje te rriqrrave gjate vitit 2020 kemi aplikuar ne OE tani I shpallur fitues dhe AK qdo here e ka favorizuar kete OE edhe perkunder qe OSHP-ja na ka rekomanduar per kontrate neve si OE por AK asnjehere nuk e ka perfille shkresat e OSHP-se deri ne momentin kur OSHP-ja e ka urdheruar AK –Komuna e Malisheves qe Brenda 10 diteve te nenshkruan kontraten me neve si OE ose perkunder do ti mirret licenca shefit te prokurimit.E gjithe kjo

procedure ka zgjatur mbi 18 muaj andaj kerkoje nga OSHP-ja qe te jete e qart dhe vigjilente sepse OE I rekomanduar per kontrate sipas LPP-se dhe dispozitave ligjore ne fuqi eshte I papergjeshem.

Ne, kemi e kemi cekur me larte dhe e kemi edhe si pretendim ankimmore se znj. Lebibe Hashani eshte punonjese e Institutit te Kombetar te Shendetit Publik gje me te cilen AK-ja, nuk eshte marr fare dhe ne vendim ka deklaruar se nuk keni ofruar kunderargumente, perderisa ne kemi kerkuar verifikim sepse eshte fakt qe instituti I mbikeqyr zbatimin e planit te veprimit per ethet hemoragjike ne nivel Kosoves duke perfshir edhe komunen e Malisheves. Pra kjo perber konflikt te hapur te intresit sepse znonja e lartpermdnur punon ne IKSHP dhe poashtu te kompania e rekomanduarper kontrate. Poashtu OE I rekomanduar per kontrate, nuk ka ofruar fare sigurim te tenderit si lider, por vetem anetari I konzorciumit, gjithe ashtu kjo bie ndesh me marreveshjen e themelimit te konzorciumit ne te cilin lideri I konzorciumit eshte zotuar se do ti realizoj mbi 60% te punimeve perderisa nuk ka ofruar asgje per kete project pervec certifikates se biznesit dhe certifikates se TVSH-se, dhe me kete pretendim AK-ja nuk eshte marr fare sepse pikerisht per kete eshte dashur te kerkoje sqarime shtese se si do ti realizoj 60% te punimeve.

Edhe sa I perket makinerise se kerkuar ne FDT, kemi kerkuar verifikim nga AK, sepse te njejtat nuk jane elektrosttike sic eshte kerkuar por jane ULV elektrike dhe me kete pretendim AK-ja nuk eshte marr fare, e qe dallimi ne mes ketyre dyja makinave eshte shume I madhe dhe krejt I kundert. Ne poashtu pretendojm se AK-ja, ne rastin e kerkesen per rishqyrtim ka bere ndryshim material te ofertes, sepse, nuk na lejon qasje ne dokumentacion, ne anen tjeter e pranon qe nuk I ka plotesuar te gjitha kerkesat OE I I rekomanduar per kontrate sepse ka kerkuar sqarime shtese dhe neve nuk na njofton me shkresat e lendes.

Kerkojme nga OSHP, qe ankesen tone ta trajtoje ne te gjitha pikat e saja dhe kerkojme te trajtohet sipas dispozitave ne fuqi sepse jemi ne dijeni se nje familjar I ngushte (vajza e pronares perkatesisht motra), punon ne OSHP dhe ndikimi I saj mund te jete shume I madh duke marre per baze pozicion e saj te punes qe e ka ne OSHP. Andaj duke u bazuar ne parimet e funksionimit te OSHP-se ne paanesi dhe profesionalizem si dhe duke u bazuar ne pretendimet tona te bazuara ankimore kerkojme nga OSHP-ja qe aktivitetin e prokurimit te kthej ne Rivleresim dhe neve si OE te na rekomandoj per dhenje te kontrates .

KRITERET PËR VLERËSIM

Njoftimi për kontratë I datës 31.03.2022.

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Përshtatshmëriae OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 – për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 deklarata nën betim.	**a. Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr.04 L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit**
2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	**b.Vertetimi nga Administrata Tatimore - duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontrate**
3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit (deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit).	**c.Vërtetimin nga Gjykata - duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontrate. Në rast të dështimit të dorëzimit të dokumenteve nën pikën b. dhe c. tenderi në fjalë do të refuzohet**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve,	**a.Vërtetimi nga Ministria për regjistrim-çertifikata e biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara (kopje),**
2.Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK	**b.Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK**
3.Çertifikata e TVSH-së.	**c.Çertifikata e TVSH-së.**
4.Leja-licenca nga ministrit perkatese per kryerjen e sherbimeve të sperkatjes	**ç.Leja-licenca nga ministrit perkatese per kryerjen e sherbimeve të sperkatjes**
5.Leja per importim dhe perdorim të produkteve biocide.	**d.Leja per importim dhe perdorim të produkteve biocide.**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Qarkullimi financiar në tri vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë minimum 90,000.00€(nëntëdhjetëmijëeuro),	**a.Raportin apo raportet përkatëse nga një ose më shumë banka per tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë që e pasqyrojn kete qarkullim,**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projektet të njëjta në vlerë prej 60,000.00Euro (gjashtëdhjetëmijëeuro) në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.	**Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të sherbimeve,Nëse kontrata është e lidhur me persona fizik, dëshmia e pagesës përmes**

	bankës).
2.Të paraqitën paisjet mjetet stabilimentet që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e sherbimit . Paisje te domosdoshme minimum kater (4) mjete transporti për bartjen e mjeteve te punes dhe punetoreve ,minimum 2 (dy) Automizer Elektrostatik multifunksional për dezinsektim hapsinor,te kete minimum njezet(20) pompa krahu per dezinsektim hapsinor,te kete se paku tre (3)Fumigator dhe minimum dy(2) depozita uji me nga 2000 litra uji	b. Lista e paisjeve , mjeteve dhe automjeteve – origjinal e nenshkruar dhe e vulosur nga OE, për të gjitha kërkesat rreth paisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave me validitet per automjetet qe kompania i ka ne pronesi ,per mjetet dhe paisjet duhet te ofrohet dëshmi DUD doganor ose Fature blerese ose te kete kontrate mbi shfrytezimin e tyre me (qera)..
3. OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së siperfaqeve kunder rriqrave – një agronom, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit.	c.Për ekspertin të sillet diploma ose çertifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni mendon dhe rekomandon për dhënie te kontrates grupit te OE"MBUROYA SH.P.K&N.SH.H ZONA PARK"me seli ne Prizren pasi që kane plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara në dosjen e tenderit dhe kan ofruar Çmim më të lire ne krahasim me oferten tjeter përgjegjëse.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit me titull: **"SPËRKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE"**, me nr. të prokurimit: **62500-22-2616-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**, ka filluar me datë 30.03.2022 –publikimi i dosjes së tenderit, hapja e ofertave është bërë me datë 12.04.2022, ndërsa vendimi i AK-së mbi rekomandimin e operatorit ekonomik është publikuar me datë 14.04.202, gjerësa OE ankuesin e shpallë të pasuksesshëm.

Operatori ankues **GOE"Samire Osmani"B.I&"Besim A.Zejnullahu"B.I** pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së me datë 26.04.2022, parashtron ankesë në OSHP me datë 04.05.2022, duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 51, 56, 59, 60, 72, 108/A të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit, krahasimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, përgjigjet si mëposhtë në pretendimet e OE ankues.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:

Sa i përket pretendimit të parë lidhur me:

"1. ***Ne FDT, keni kerkuar pajisje, mjete dhe stabilimente dhe nder te tjera keni kerkuar tre (3) fumigator dhe DY DEPOZITA UJI ME NGA 2000 LITRA. Gjate qasjes bashke me zyrtarin te prokurimit konstatuam se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar as minimumin e kerkeses per faktin se ne ofert ka ofruar depozita te cilat nuk e arrijn as 1000 LITRA. Sa i perket 2 depozitave te kerkuara, se pari nuk pranohet qe te ofrohen disa depozita sepse AK-ja ka kerkuar vetem 2 depozita me nga 2000 litra. I rekomanduari per kontrate ne listen e pajisjve e ka dhene vetem nje depozit dhe per te njejten nuk ka ofruar asnje deshmi sic eshte kerkuar fatura, Dud ose Kontrate te shfrytezimit me qera"***

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT tek kërkesat mbi mundësit teknike&profesionele 9.1&9.2 ka kërkuar:

"**- tre (3) Fumigator dhe minimum dy (2) depozita uji me nga 2000 litra."**
Dëshmia:
"b. Lista e paisjeve , mjeteve dhe automjeteve – origjinal e nenshkruar dhe e vulosur nga OE, për të gjitha kërkesat rreth paisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave me validitet per automjetet qe kompania i ka ne pronesi ,per mjetet dhe paisjet duhet te ofrohet dëshmi DUD doganor ose Fature blerese ose te kete kontrate mbi shfrytezimin e tyre me (qera).."

Gjerësa, OE i rekomanduar në ofertën ka të bashkangjitur listën e pajisjeve ku posedon vetëm një depozitë ujit nën peshën e kërkuar, dhe si e tillë **pretendim i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:

Sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

"2. ***Ne FDT, keni kerkuar epidemiolog ose biolog te diplomuar. I rekomandauri per kontrate ka ofruar diplomen e epidemiologes Lebibe Hashanit, e cila eshte punetore e Institutit Komebtare te Shendetit Publik ne Prizren, e cila perben konflkt te hapur interesi per faktin se implementimi i projektit ne fjale menaxhohet me IKSHP dhe komunen e Malisheves***"

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT ka kërkuar:

"**3. OE të ketë ekspertin për lëminë e spërkatjes së siperfaqeve kunder rriqrave – një ekolog, epidemiolog ose biolog i diplomuar në cilësi te ekspertit."**

Dëshmia:" c.Për ekspertin të sillet diploma ose çertifikata kopje, CV-ja e tij dhe kontrata e punës"

Tutje, në ofertën e OE të rekomanduarit në listën e stafit (eksperti) janë të bashkangjitur një Epidemiolog, dhe një Biolog me drejtimin ekologji (Ekolog) dhe si e tillë, me vet faktin që AK ka kërkuar një ekspert, atëherë përkundër pretendimit lidhur me epidemiologen e cila në CV po ashtu ka të deklaruar që punon në IKSHPK, OE i rekomanduar e plotëson kriterin. Andaj **pretendimi nuk gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:

Sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues kundër OE të rekomanduari:

"3. ***Ju keni kerkuar sigurim te ofertes dhe gjate qasjes kemi verejtur se sigurimi i ofertes eshte ne emer te anetarit te konzorciumit e cila bie ne kundershtim me vet marreveshjen e themeimit te konzorciumit sepse lider ne kete aktivitet te prokurimit eshte Mburoya Shpk, dhe ne kete rast grupi i operatoreve ekonomik ne marrveshjen e themelimit te konzorciumit jane deklaruar se Mburoya do ti perfundoje 60% te puneve e cila ne ofert ka dorezuar vetme certifikaten e biznesit, TVSH-se dhe deklaraten nen betim dhe ne kete rast as sigurim te ofertes nuk ka ne emer te liderit e cila eshte ne kundershtim me dispozitat e ligjit per prokurim publik***"

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me sigurimin e ofertës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet sigurimi i ofertës për aktivitetin e njejtë me nr të njejtë të aktivitetit të prokurimit, dhe përderisa operatorët ekonomik kanë ofertuar si grup në tërsi, si e tillë sigurimi konsideroj se gjendet i vlefshëm, dhe pretendimi i OE **ankues nuk gjendet i bazuar.**

Neni 71 i LPP-së:

3. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.

4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4:

Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

"4. Ne FDT, te pajisjet keni kerkuar 2 automizer elektrostatik multifunksional per dezinfektim hapesinore. OE i reomanduar per kontrate ne deshmit e ofruar per kete pajisje ka ofruar pajisje te cilat nuk jane ELEKTROSTATIKE sic jane kerkuar, por jane elektrike dhe per pajisjen ne fjal kerkojme qe te verifikohen"

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT tek pjesa 9.1&9.2 ka kërkuar:

"**- 2 (dy) Automizer Elektrostatik multifunksional për dezinsektim hapsinor"**

Dëshmia:"b. Lista e paisjeve , mjeteve dhe automjeteve – origjinal e nenshkruar dhe e vulosur nga OE, për të gjitha kërkesat rreth paisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë në kopje (kopjet e librezave me validitet per automjetet qe kompania i ka ne pronesi ,per mjetet dhe paisjet duhet te ofrohet dëshmi DUD doganor ose Fature blerese ose te kete kontrate mbi shfrytezimin e tyre me (qera).."

Tutje, OE i rekomanduar në ofertë ka të bashkangjitur Automizer NEBUROTOR i cili është rezultat i një zhvillimi të vazhdueshëm për funksionim dhe trajtim më të lehtë. Detajet teknike janë të njëjta, por i vendosur në një panel, ai mund të rrotullohet automatikisht midis 90° dhe 360°.

Mirëpo, meqenëse AK në DT ka kërkuar Automizer elektrostatik multifunksional, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Tutje, sa i përket pretendimit të OE ankues kundër Autoritetit Kontraktues lidhur me mosdhënien e informatave të plota lidhur me ofertën e Operatorit ekonomik, mund të sqaroj se, OE-të paraparkishtë kanë nënshkruar deklaratën mbi informatat sekrete afariste.

Aneksi 3. KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET

Për: Komuna e Malishevës

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE N.SH.H "ZONA PARK" (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

1. Kapaciteti ekonimik & financiar

2. Kapaciteti teknik & profesional

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:

Për shkakë se dokumentet e lartëcekura po keqpërdoren nga konkurentet tjerë duke manipuluar me ato dokumente kërkojm që në bazë të dispozitave ligjore të LPP-së të mbeten sekrete afariste.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE **"Samire Osmani"B.I&"Besim A.Zejnullahu"B.I** të aprovohet si pjesërisht e bazuara, gjerësa vendimi i AK-së të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Panelit Shqyrtues **- OSHP**

OE ankues **- "Samire Osmani"B.I&"Besim A.Zejnullahu"B.I**